



Instituti i Kosovës për Drejtësi  
Kosovo Law Institute  
Kosovski Institut Prave



# Doracak

për shpalljen e grevës së ligjshme



Autor: Naim Jakaj

Ekipi redaktues: Ehat Miftaraj, Betim Musliu, Gzim Shala dhe Arrita Rezniqi.

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

*Ky publikim është bërë i mundur nga mbështetja bujare e popullit amerikan nëpërmjet Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Përmbajtja është përgjegjësi e Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD) dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.*

*Publikimi është realizuar në kuadër të Programit për Angazhim Qytetar, i cili zbatohet nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në partneritet me Agjencinë e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) në Kosovë. IKD është partnere e KCSF në realizimin e këtij aktiviteti.*



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA



KOSOVO LAW INSTITUTE  
INSTITUTI I KOSOVËS PËR DREJTËSI  
KOSOVO SKLPI INSTITUT FRAJKA



FONDACIONI KOSOVAR PËR SHOQËRI CIVILE  
KOSOVAR CIVIL SOCIETY FOUNDATION

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD, Rr. Ilaz Agushi  
Prishtinë  
E: [info@kli-ks.org](mailto:info@kli-ks.org)  
[www.kli-ks.org](http://www.kli-ks.org)

30 Prill, 2024  
Prishtinë, Republika e Kosovës



# PËRMBAJTJA

07	SHKURTESAT
09	LISTA E FORMAVE (DIALOGU SOCIAL)
09	LISTA E FORMAVE (TUBIMET PUBLIKE)
09	LISTA E FORMAVE (ORGANIZIMI I GREVËS SË LIGJSHME)
11	1. Hyrje
12	2. E drejta e grevës
13	3. Metodatat alternative për të mos përfunduar në grevë
13	3.1 Dialogu Social
13	3.2 Protesta
15	4. Veprimet procedurale për shpalljen e grevës së ligjshme
16	5. Mënyrat e Organizimit të Grevës
16	6. Veprimet para krijimit të Këshillit Grevist
16	7. Veprimet pas dështimit të arritjes së marrëveshjes
16	7.1 Krijimi i Këshillit Grevist
17	7.2 Paralajmërimi publik i punëdhënësit për grevën një (1) orëshe
18	7.3 Vendimi për grevën paralajmëruese një (1) orëshe
18	7.4 Njoftimi për grevën paralajmëruese një (1) orëshe
19	7.5 Komunikimi i përditshëm me publikun
20	7.6 Kërkesë për takim me punëdhënësin
20	7.7 Njoftimi për dështimin e grevës një (1) orëshe dhe dialogut social
20	7.8 Paralajmërimi publik për hyrje në grevë të përgjithshme
21	7.9 Kërkesë grupeve shoqërore për mbështetje në realizimin e kërkesave
21	7.10 Kërkesë për takim me Avokatin e Popullit
22	7.11 Kërkesë për takim me Komisionin Parlamentar FunkSIONAL
22	7.12 Vendimi për caktimin e ndërmjetësuesit
23	7.13 Njoftimi i ndërmjetësuesit për rezultatin e dialogut me punëdhënësin
23	7.14 Vendimi për hyrje në grevë të përgjithshme
24	7.15 Njoftimi publik për hyrje në grevë të përgjithshme
24	7.16 Caktimi i ekipeve kujdestare dhe shëndetësore
25	8. Veprimet pas hyrjes në grevë në nivel vendi
25	8.1 Kërkesë grupeve parlamentare për seancë të jashtëzakonshme në Kuvendin e Kosovës
25	8.2 Komunikimi i përditshëm me punëtorët
26	8.3 Konferencë për medie-njoftimi për rezultatin e kërkesave



## SHKURTESAT

<b>KEDNj</b>	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
<b>KSE</b>	Karta Sociale Evropiane
<b>DUEDNj</b>	Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut
<b>DONPPDThP</b>	Deklarata e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) mbi Parimet dhe të Drejtat Themelore në Punë
<b>PADESK</b>	Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore
<b>KRK</b>	Kushtetuta e Republikës së Kosovës
<b>LOSK</b>	Ligji për Organizimin Sindikal në Kosovë
<b>LG</b>	Ligji për Grevat
<b>ShRJ</b>	Shërbime të rëndësishme jetike
<b>KG</b>	Këshilli Grevist
<b>BSPK</b>	Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës
<b>SBASHK</b>	Sindikata e Bashkuara e Arsimit të Kosovës
<b>MFPT</b>	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
<b>KRK</b>	Kuvendi i Republikës së Kosovës
<b>KPF</b>	Komision Parlamentar FunkSIONAL
<b>ZKM</b>	Zyra e Kryeministrit





# LISTA E FORMAVE

## LISTA E FORMAVE (DIALOGU SOCIAL)

- Forma 1, Kërkesë për takim me punëdhënësin

## LISTA E FORMAVE (TUBIMET PUBLIKE)

- Forma 2, Paralajmërimi i Sindikatës për punëdhënësin për protestë paqësore
- Forma 3, Lajmërimi i Policisë së Kosovës për mbajtjen e tubimit publik
- Forma 3.1, Lajmërimi i Policisë së Kosovës për mbajtjen e tubimit publik
- Forma 4, Njoftimi për medie dhe për opinionin publik për mbajtjen e tubimit paqësor
- Forma 5, Skenari për tubimin paqësor
- Forma 6, Komunikatë për medie

## LISTA E FORMAVE (ORGANIZIMI I GREVËS SË LIGJSHME)

- Forma 7, Kërkesë për takim me punëdhënësin
- Forma 8, Vendim për krijimin e Këshillit Grevist
- Forma 9, Paralajmërimi publik për punëdhënësin për hyrje në grevë një orëshe
- Forma 10, Vendimi për hyrje në grevë paralajmëruese një orëshe
- Forma 11, Regjistri i pjesëmarrësve të punëtorëve në grevën një orëshe
- Forma 12, Njoftimi për medie dhe për publikun për vendimin për hyrje në grevë paralajmëruese një orëshe
- Forma 13, Kërkesë për takim me punëdhënësin
- Forma 14, Njoftimi i Këshillit Grevist për dështimin e dialogut social dhe grevës një orëshe
- Forma 15, Paralajmërimi i Këshillit Grevist për punëdhënësin për hyrje në grevë të përgjithshme
- Forma 16, Kërkesë grupeve shoqërore për mbështetje në realizimin e kërkesave
- Forma 17, Kërkesë për takim me Institucionin e Avokatit të Popullit
- Forma 18, Kërkesë për takim me Komisionin Parlamentar FunkSIONAL
- Forma 19, Vendim për caktimin e ndërmjetësuesit
- Forma 20, Njoftimi i ndërmjetësuesit për rezultatin e dialogut
- Forma 21, Vendimi për hyrje në grevë të përgjithshme
- Forma 22, Regjistri i pjesëmarrësve të punëtorëve në grevën e përgjithshme
- Forma 23, Njoftimi i publikut për hyrje në grevë të përgjithshme
- Forma 24, Caktimi i ekipeve kujdestare dhe shëndetësore
- Forma 25, Kërkesë për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme nga Kuvendi i Kosovës



# 1. Hyrje

Në Kosovë, aktualisht janë të regjistruara 236 organizata sindikale, prej të cilave 1 konfederatë, 12 federata dhe 223 shoqata. Por, përkundër faktit që ato janë të regjistruara dhe përkundër faktit që kjo e drejtë është e garantuar, deri më sot aktiviteti sindikal është përshkruar me mungesë unifikimi të procedurave që duhen ndjekur për të organizuar një grevë të ligjshme. Në numër janë të vogla sindikatat që kanë ndjekur procedurat e duhura ligjore që një grevë të përfundojë e ligjshme. Rrjedhimisht, në vazhdimësi grevat e organizuara, veçanërisht nga sindikatat më të vogla janë kontestuar e për pasojë edhe është bërë cenimi i tyre.

Ky cenim, në drejtim të organizatave sindikale është drejtuar kryesisht te kontestimi i ligjshmërisë së shpalljes së grevës, në mënyrë që institucionet e caktuara të kenë më të lehtë zbatimin e dispozitave ligjore për t'i sanksionuar ato. Ky kontestim shpeshherë ka ardhur si pasojë e njohurive jo të duhura nga sindikatat e vogla me traditë të shkurtër sindikale për procedurën që duhet ndjekur për shpalljen e grevës së ligjshme.

Për këtë arsye, IKD së bashku me Bashkimin e Sindikatave të Pavarura të Kosovës dhe në bashkëpunim të veçantë me Sindikatën e Bashkuar të Arsimit të Kosovës, kanë adresuar këtë çështje duke hartuar këtë doracak i cili do të përmbajë shpjegimin hap pas hapi dhe informimin e duhur për procedurën, qasjen dhe metodën që duhet ndjekur për shpalljen e grevës së ligjshme. Këtij doracaku do t'i bashkëngjiten edhe gjedhet (modelet) e shkresave të cilat do ta lehtësojnë dhe do t'u ndihmojnë në masë të madhe sindikatave.

Përpilimi dhe publikimi i një doracaku të këtillë do të jetë i dobishëm për të gjitha sindikatat që veprojnë në Kosovë, duke ua lehtësuar angazhimin dhe përfshirjen në aktivitete sindikale për të realizuar të drejtat e tyre me shfrytëzimin e mekanizmit kushtetues dhe ligjor të grevave.

Doracaku është hartuar bazuar në infrastrukturën ligjore të Republikës së Kosovës: në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, në Ligjin Nr. 04/-L-011 për Organizimin Sindikal, në Ligjin Nr. 03/L -200 për Grevat, në Ligjin Nr. 08/L-166 për Tubimet Publike, Ligjin Nr. 03/L-212 të Punës, dhe në aktet ligjore përkatëse.

## 2. E drejta e grevës

Të gjithë punëtorët në sektorin publik ose në atë privat e kanë të drejtën demokratike për të hyrë në grevë, përveç personelit në Forcën e Sigurisë së Kosovës, Policinë e Kosovës, Shërbimet e Zjarrfikësve, Shërbimet Emergjente Shëndetësore dhe në organet e tjera me interes të veçantë për Republikën e Kosovës. Megjithatë, edhe në institucionet e tjera ku lejohet greva, mund të ketë kufizime të caktuara, në rast se këto institucione ushtrojnë veprimtari me interes të veçantë publik. Në këtë rast, këto institucione kanë të drejtë të hyjnë në grevë, me kusht që të sigurohet minimumi i procesit të punës dhe prodhimit, që të sigurohet jeta dhe shëndeti i njerëzve, apo mos shkaktimi i dëmeve me pasoja të mëdha.

Se sa respektohet dhe se sa nuk cenohet e drejta e grevës, vlerësohet edhe shkalla e demokracisë dhe e drejtësisë sociale të një vendi. Në kornizën e idealeve të demokracisë, grevat kanë një rol të rëndësishëm në shprehjen e lirisë dhe të organizimit të punëtorëve. Për t'u arritur ky ideal, e rëndësishme dhe e patejkalueshme është që organizimi dhe veprimet sindikale, në këtë rast grevat të jenë të organizuara dhe të jenë në përputhje me Kushtetutën, aktet ndërkombëtare, në pajtim me ligjet, aktet nënligjore dhe statutet sindikale. E rëndësishme po ashtu është edhe që punëdhënësi dhe organizatat e punëtorëve të jenë të hapura për dialog dhe të gatshme për gjetur zgjidhje të pranueshme për të gjitha palët e përfshira.

Kushtetuta e Kosovës ka garantuar lirinë për të krijuar sindikata dhe për të ushtruar veprimtari sindikale si njërin ndër aspektet themelore të të drejtave të punës. E drejta për të formuar dhe për t'u anëtarësuar në sindikata dhe për të ushtruar aktivitete sindikale është e rregulluar edhe me dokumente ndërkombëtare: Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Deklarata e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) për Parimet dhe të Drejtat Themelore në Punë dhe Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore.

Përveç Kushtetutës, akteve ndërkombëtare, e drejta për të krijuar sindikata dhe për të ushtruar aktivitete sindikale mbrohet edhe me ligje të caktuara. Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin për Organizimin Sindikal në Kosovë, Ligjin për Grevat dhe ndryshimet dhe plotësimet në të, Ligjin për tubimet publike, si dhe Ligjin e Punës.

Bashkimi në Sindikata dhe ushtrimi i veprimtarive sindikale është thelbësor për funksionimin e shoqërive demokratike ku punëtorët në bashkësi më të mëdha bashkohen për të ndjekur qëllime të përbashkëta dhe për t'i mbrojtur interesat e tyre të cilat mund të përfshijnë kushte më të mira të punës, paga më të larta dhe përfitime të tjera.

### 3. Metodat alternative për të mos përfunduar në grevë

Para secilit organizim sindikal në kuptim të grevës, sindikatat duhen të shqyrtojnë të gjitha çështjet përmes diskutimeve të brendshme për t'u dhënë përgjigje në disa pyetje thelbësore: a është bërë hulumtim i mirë për çështjen që duhet ngritur, a është shfrytëzuar dialogu social për të mos përfunduar në grevë, a janë punëtorët të përgatitur për të ndërmarrë veprime, sa e rëndësishme është kërkesa, çfarë lloji i grevës duhet iniciuar, a është marrë mbështetje tjetër publike për grevën nga grupet e caktuara shoqërore dhe nga mediat, cilat rrugë ligjore procedurale duhen ndjekur për grevën, etj.?

#### 3.1 Dialogu Social

Fillimisht, sindikata duhet të përdorë mekanizmin e Dialogut Social, procesit me anë të të cilit qeveritë, punëdhënësit dhe punonjësit bashkëpunojnë për të marrë vendime në lidhje me vendin e punës dhe çështjet që lidhen me punësimin. Përfaqësuesit e këtyre grupeve duhen të angazhohen që në forma të ndryshme të negocimit, konsultimit dhe shkëmbimit të informacionit në lidhje me interesat e përbashkëta për marrëdhëniet e punës, çështjet ekonomike dhe sociale të arrihen përmes marrëveshjeve.

Dialogu social u siguron punëtorëve zë në vendet e tyre të punësimit dhe shërben si një mjet për arritjen e përparimit social dhe ekonomik. Në këtë drejtim, dialogu social shërben për parandalimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve eventuale. Para secilës iniciativë për të hyrë në aktivitete sindikale masive, sindikatat kanë parasysh veprimet që mund t'i ndërmarrin për të shmangur hyrjen në grevë. (*Shih Formën 1, Kërkesë për takim me punëdhënësin*).

#### 3.2 Protesta

Në plan të dytë, sindikata duhet të shfrytëzojë mjetin e protestës si njërin ndër aktivitetet e tjera për të parandaluar një grevë të caktuar, ku tubimet publike mund të bëjnë tryshnië ndaj punëdhënësit në mënyrë që ai t'i adresojë arsyet e pakënaqësisë. Rrjedhimisht, punëdhënësit mund të parandalojnë nevojën për veprime të tjera sindikale, të ruhet produktiviteti i punës dhe mosmarrëveshjet të zgjidhen përmes komunikimit dhe negocimit. (*Shih Formën 2, Paralajmërimi i Sindikatës për punëdhënësin për protestë paqësore*).

Këto tubime mund të përfshijnë organizimin e marsheve, protestave dhe demonstratave të cilat organizohen në pajtim me Ligjin për Tubimet Publike.[1] Iu përket sindikatave të vendosin objektiva për t'i arritur ato të cilat mund të jenë: kushte më të mira në kontratat e punës, rritjen e ndërgjegjësimit për çështje specifike të vendit të punës, mbledhjen e mbështetjes publike për kauzat e punëtorëve dhe ushtrimin e presionit mbi punëdhënësit ose politikëbërësit për të miratuar ndryshime të dobishme për punëtorët. (*Shih Formën 3, Lajmërimi i Policisë së Kosovës për mbajtjen e tubimit publik*).

Përgjatë historisë, ligjet dhe çështjet që lidhen me kushtet e punës janë ndikuar shumë nga demonstratat e sindikatave. Më parë është protestuar për ditën e punës në tetë orë, rregulla të sigurisë në vendin e punës dhe në nxjerrjen e ligjeve që përjashtojnë fëmijët nga vendi i punës. Ndërsa, sot këto protesta janë fokusuar në tema si përfitimet nga kujdesi shëndetësor, siguria e daljes në pension, pabarazitë ekonomike, kontraktimi i vendeve të punës dhe punësimi i pasigurt.

Për mbajtjen e tubimit publik në formën e protestës paqësore, sindikata njofton edhe mediat e opinionin publik. (*Shih Formën 4, Njoftimi për medie dhe për opinionin publik për mbajtjen e tubimit paqësor*).

Po ashtu është e rëndësishme që sindikata të hartojë skenar të detajuar që e miraton në organin përkatës dhe se i përmbahet deri në përfundimin e grevës. (*Shih për më shumë Formën 5, Skenari për tubimin paqësor*).

E rëndësishme për sindikatën por në veçanti për opinionin, që ajo të lëshojë komunikatë pas mbajtjes së tubimit paqësor ku tregohet për mbarëvajtjen e protestës, qëllimin pse është thirr, kërkesat e sindikatës si dhe cilat hapa do të ndërmerren më tutje, (*Shih Formën 6, Komunikatë për medie*).

---

[1] "Ligji për Tubime Publike", 27 shkurt 2023, Kuvendi i Kosovës. (Shih linkun <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=70935>). (Qasur për herë të fundit me 10 prill 2024).

## **4. Veprimet procedurale për shpalljen e grevës së ligjshme**

Sipas Ligjit Nr. 03/L-200 për Greva, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-119, janë tre faza që duhet ndjekur për inicimin, zhvillimin dhe përfundimin e një greve të ligjshme, ku secila prej tyre përbëhet nga hapat që duhet të ndërmerren.

### **Faza e parë**

1. Kërkesë për takim me punëdhënësin.

### **Faza e dytë**

1. Kërkesë për takim me punëdhënësin;
2. Vendimi për krijimin e Këshillit Grevist;
3. Paralajmërimi publik për punëdhënësin për hyrje në grevë një (1) orëshe;
4. Vendimi për hyrje në grevë paralajmëruese një (1) orëshe;
5. Regjistri i pjesëmarrësve së punëtorëve në grevën një (1) orëshe;
6. Njoftimi për medie dhe për publikun për vendimin për hyrje në grevë paralajmëruese një (1) orëshe;
7. Kërkesë për takim me punëdhënësin;
8. Njoftimi i Këshillit Grevist për dështimin e dialogut social dhe grevës një (1) orëshe;
9. Paralajmërimi i Këshillit Grevist për punëdhënësin për hyrje në grevë të përgjithshme;
10. Kërkesë grupeve shoqërore për mbështetje në realizimin e kërkesave;
11. Kërkesë për takim me Institucionin e Avokatit të Popullit;
12. Kërkesë për takim me Komisionin Parlamentar FunkSIONAL;
13. Vendim për caktimin e ndërmjetësuesit;
14. Njoftimi i ndërmjetësuesit për rezultatin e dialogut;
15. Vendimi për hyrje në grevë të përgjithshme;
16. Regjistri i pjesëmarrësve së punëtorëve në grevën e përgjithshme;
17. Njoftimi i publikut për hyrje në grevë të përgjithshme;
18. Caktimi i ekipeve kujdestare dhe shëndetësore;
19. Kërkesë për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme nga Kuvendi i Kosovës.

### **Faza e tretë**

1. Konferencë për medie-njoftimi për rezultatin e kërkesave.

## 5. Mënyrat e Organizimit të Grevës

Sipas Ligjit për Greva, ato mund të organizohen në forma të ndryshme. Greva mund të organizohet, përmes formës së ndërprerjes së punës në vendin e punës, tubimit të të punësuarve në hapësirat e punës, mungesës së të punësuarve nga puna dhe tubimit të të punësuarve jashtë ambienteve të punës, dhe në hapësira tjera.

## 6. Veprimet para krijimit të Këshillit Grevist

Dështimi për të arritur marrëveshje ndërmjet sindikatës dhe punëdhënësit përmes dialogut social dhe përmes tubimeve publike nuk duhet medoemos të shtyjë sindikatën për nisjen e procedurave për shpalljen e grevës së ligjshme. Para se të fillojnë veprimet për shpalljen e grevës së ligjshme, sindikata mund të procedojë me kërkesa të reja për takime shtesë me punëdhënësin për t'i adresuar kërkesat dhe për të arritur marrëveshje. (*Shih formën nr. 7, Kërkesë për takim me punëdhënësin*).

Sindikata mund të japë një afat kohor të arsyeshëm prej shtatë ditëve për kthimin e përgjigjes nga ana e punëdhënësit.

## 7. Veprimet pas dështimit të arritjes së marrëveshjes

Para secilit organizim sindikal në kuptim të grevës, sindikatat duhen të shqyrtojnë të gjitha çështjet përmes diskutimeve të brendshme për t'u dhënë përgjigje në disa pyetje thelbësore: a është bërë hulumtim i mirë për çështjen që duhet ngritur, a është shfrytëzuar dialogu social për të mos përfunduar në grevë, a janë punëtorët të përgatitur për të ndërmarrë veprime, sa e rëndësishme është kërkesa, çfarë lloji i grevës duhet iniciuar, a është marrë mbështetje tjetër publike për grevën nga grupet e caktuara shoqërore dhe nga mediat, cilat rrugë ligjore procedurale duhen ndjekur për grevën, etj.?

### 7.1 Krijimi i Këshillit Grevist

Për fillimin e një greve të ligjshme është e obligueshme që të krijohet Këshill Grevist, i cili duhet të kujdeset për zbatimin e të gjitha kritereve dhe kushteve të parapara me Ligjin për Greva. Këshilli zgjedhet nga të punësuarit, i përfaqëson interesat e të punësuarve, udhëheq dhe koordinon grevën në emrin e tyre. (*Shih formën nr. 8, Vendim për krijimin e Këshillit Grevist*).



Përgjegjësitë dhe detyrat e tjera specifike të Këshillit Grevist përfshijnë: zhvillimi i strategjisë për zhvillimin e grevës ku përfshihen përcaktimi i qëllimeve dhe detajizimi i pikave për diskutim; zhvillimin e komunikimit ndërmjet punëtorëve grevistë dhe palëve të interesit, në këtë rast punëdhënësin, mediat dhe komunitetin. Më tutje, KG ka përgjegjësinë në koordinimin e aspekteve të ndryshme të grevës, aktivitetet brenda dhe jashtë grevës, duke përfshirë edhe menaxhimin e fondeve të grevës dhe sigurimin e pajtueshmërisë me kërkesat ligjore.

Përfaqësimi i punëtorëve grevistë në negociatat me punëdhënësin, duke përfshirë paraqitjen e kërkesave, angazhimin në negociata dhe arritjen e marrëveshjes, sigurimi që greva i përmbahet Kushtetutës, ligjeve, akteve nënligjore dhe statuteve të sindikatave, ofrimi i mbështetjes në kujdes shëndetësor dhe në ndihmë financiare të grevistëve janë përgjegjësi e Këshillit Grevist.

Komunikimi, edukimi dhe ndërtimi i aleancave me sindikatat e tjera, komunikimi me komunitetin dhe me publikun janë po ashtu të rëndësishme sa i përket ndërtimit të solidaritetit dhe kohezionit të jashtëm.

Gjatë grevës KG duhet të jetë në gjendje të vlerësojë progresin dhe efektivitetin e grevës duke marrë për bazë reagimin e grevistëve, monitorimin e veprimeve të veta dhe të punëdhënësit dhe ndryshimin e veprimeve sipas nevojës.

Për fund, është detyrë e KG që të arrijë marrëveshje në bazë të kushteve të dakorduara me rastin e hyrjes në grevë. Në rast të marrëveshjes, KG duhet që të monitorojë zbatimin e marrëveshjeve të arritura gjatë dialogut dhe adresimin e çdo ankese të mbetur.

## **7.2 Paralajmërimi publik i punëdhënësit për grevën një (1) orëshe**

Këshilli Grevist, para se të marrë vendim për të hyrë në grevë një orëshe, e njofton punëdhënësin se do të hyjë në grevë një orëshe. Qëllimi i këtij paralajmërimi është të tregojë gatishmërinë e përgjithshme për grevë në mbështetje të kërkesave të bëra gjatë dialogut social të cilat nuk janë realizuar. *(Shih formën nr. 9, Paralajmërimi publik për punëdhënësin për hyrje në grevë një (1) orëshe).*

Sindikatat e kanë të rëndësishme njoftimin për grevën paralajmëruese si një strategji negociuese me punëdhënësit. Njoftimi i tillë mund të prodhojë situatën kur punëdhënësi të fillojë negociimin për një marrëveshje në mënyrë që të mos shkohet as në grevë paralajmëruese. Një njoftim i tillë, në krahasim me grevën një orëshe dhe grevën e plotë ka për qëllim që punëdhënësit t'i bëjë të ditur se punëtorët janë të gatshëm të marrin masa më drastike nëse kërkesat e tyre nuk plotësohen.

### **7.3 Vendimi për grevën paralajmëruese një (1) orëshe**

Në mënyrë që të shmanget greva e gjatë e cila mund të sjell pasoja ekonomike të kushtueshme dhe pasoja të tjera sociale dhe politike, Këshilli Grevist ka për detyrë që të paralajmërojë grevën e cila sipas Ligjit për Greva duhet të jetë në kohëzgjatje prej një orë. KG, grevën e paralajmëron tek punëdhënësi dhe sindikata dhe këtë paralajmërim ka për detyrë që ta dorëzojë jo më vonë se shtatë (7) ditë nga dita e caktuar për fillimin e grevës.

Ligji për Greva ka përcaktuar kushte të cilat duhet t'i përmbajë vendimi i KG për t'u cilësuar një grevë paralajmëruese e ligjshme, ku përfshihen arsyet e mbajtjes së grevës paralajmëruese, kërkesat e punëtorëve, vendin ku do të mbahet greva, kohën e fillimit dhe ditën e mbajtjes së grevës, si dhe kërkesën për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në mënyrë paqësore. Kohëzgjatja e grevës paralajmëruese mund të zgjasë deri në një (1) orë në ditë. *(Shih formën nr.10, Vendimi për hyrje në grevë paralajmëruese një (1) orëshe).*

Ky lloj i grevës është llogaritur si një metodë për të bërë presion mbi punëdhënësin në mënyrë që atij t'i jepet edhe një kohë shtesë për t'u ulur në tavolinë dhe për të arritur marrëveshje me sindikatën, para se të shkohet në grevë të gjerë dhe të plotë.

KG, në secilin rast të grevës një orëshe duhet që të mbajë regjistër të pjesëmarrësve. *(Shih formën 11, Regjistri i pjesëmarrësve së punëtorëve në grevën një (1) orëshe).*

### **7.4 Njoftimi për grevën paralajmëruese një (1) orëshe**

Komunikimi me publikun është thelbësor që një grevë të marrë mbështetje të gjerë shoqërore. Në këtë çështje KG dhe sindikata duhet të jetë në vazhdimësi në komunikim me mediat, organizatat e shoqërisë civile dhe secilin të interesuar që mund të ndihmojë ose të kërkojë informata për zhvillimin e grevës.

Në këtë drejtim, pas vendimit për të hyrë në grevë paralajmëruese një orëshe, e njëjta duhet të bëhet publike përmes mediave dhe ky njoftim t'i dërgohet edhe punëdhënësit si dhe përfaqësuesve të zgjedhur të qytetarëve, deputetët. *(Shih formën nr. 12, Njoftimi për medie dhe për publikun për vendimin për hyrje në grevë paralajmëruese një (1) orëshe).*

Mesazhi që do të përdoret në njoftime të tilla duhet të jetë i qartë dhe i saktë që përshkruan arsyet e grevës, kërkesat e punëtorëve dhe rezultatet e pritura. Në secilën situatë, duhet të shmanget gjuha që mund ta bëjë konfuz mesazhin.

## **7.5 Komunikimi i përditshëm me publikun**

KG, duhet të identifikojë edhe zëdhënësit kryesor që komunikojnë me publikun e të cilët mund të jenë Kryetari i KG dhe anëtarët e tjerë të KG-së. Por, në raste të caktuara për shkak që ata mund të jenë të angazhuar edhe në detyra të tjera mund të mos mbërrijnë të jenë të qasshëm dhe të shpejtë, andaj KG duhet t'i identifikojë punëtorë të artikuluar që shërbejnë për komunikim me publikun e të cilët janë në gjendje të përcjellin në mënyrë efektive mesazhin në media dhe publikun.

Zëdhënësit duhet të jenë të gatshëm të lëshojnë njoftime për shtyp për të dhënë detaje të përditësuar në kohë reale, të cilat duhet t'u shpërndahen medieve, të shpërndahen në rrjete sociale. Ata duhet të jenë të aftë dhe të përditësuar me zhvillimet e reja në rrjetet sociale në mënyrë që të jenë sa më afër publikut. Krijimi i hashtagëve për të unifikuar bisedat në Facebook, Instagram dhe Tik Tok duhen të përdoret sa më shumë që mesazhi i unifikuar të mbërrijë tek qytetarët. Zëdhënësit duhet të jenë transparent dhe të sigurohen që informacionet të jenë të sakta kur bëhet fjalë për kundërshtimin e çdo gënjeshtre që mund të prodhojë punëdhënësi.

Zëdhënësit duhet të angazhohen edhe me punëtorët, duke i informuar ata për zhvillimet nga ana e punëdhënësit, kjo bëhet në koordinim me KG.

Një çështje tjetër që duhet të bëhet është furnizimi i publikut me informacione mbi përparimin e dialogut me punëdhënësin dhe çdo zhvillim që lidhet me grevën dhe çdo ndryshimet në strategji. Transparenca ndërton besim dhe besueshmëri.

## **7.6 Kërkesë për takim me punëdhënësin**

Kur një sindikatë punëtorësh ka hyrë në grevën një orëshe të përditshme, është e rëndësishme që ajo të kërkojë takime të reja me punëdhënësin si një formë e dialogut social dhe formë e parandalimit për grevë të përgjithshme. Kërkesa ndaj punëdhënësit duhet të jetë e qartë, e saktë dhe formale në të cilën shpjegohen në mënyrë të detajuar të gjitha çështjet që duhet zgjidhur me punëdhënësin, (*Shih formën 13, Kërkesë për takim me punëdhënësin*).

## **7.7 Njoftimi për dështimin e grevës një (1) orëshe dhe dialogut social**

Ashtu siç është i rëndësishëm komunikimi me publikun për procesin fillestar, njëjtë duhet të jetë edhe komunikimi për epilogun e dialogut social, veçanërisht kur ai përfundon me dështim duke mos arritur marrëveshje. Sindikata duhet të sigurojë informacion të qartë dhe transparent mbi zhvillimet rreth dështimit të dialogut social.

Në njoftimin e saj, KG informon për përpjekjet e mira të saj, për dialogun social me punëdhënësin si dhe për rezultatet e papritura. Në njoftim duhet të thuhet se dështimi i tillë nuk paraqet pengesë për aktivitete të tjera dhe as nuk e zvogëlon vendosmërinë e sindikatës dhe punëtorëve për të vazhduar luftën për paga të drejta, kushte të sigurta pune dhe çështje të tjera të rëndësishme që prekin ata. Krejt në fund, punëtorët njoftohen se ata do të mbahen të informuar për çdo zhvillim dhe hapa të ardhshëm. (*Shih formën 14, Njoftimi i Këshillit Grevist për dështimin e dialogut social dhe grevës një (1) orëshe*).

## **7.8 Paralajmërimi publik për hyrje në grevë të përgjithshme**

Dështimi i dialogut social për të arritur marrëveshje në bazë të kërkesave të sindikatës do të kuptohet se kërkesat mund të arrihen vetëm përmes grevës, por para se punëtorët të hynë në grevë të përgjithshme, ata mund të provojnë që përmes metodave të tjera alternative të bëjnë presion për marrëveshje potenciale.

Në këtë drejtim, paralajmërimi publik për hyrje në grevë të përgjithshme duhet të bëhet nga sindikata për të treguar se për arsye të dështimit të arritjes së një marrëveshje, ata janë të obliguar të hynë në grevë të përgjithshme.

Paralajmërimi publik duhet të bëhet për punëdhënësin dhe për opinionin publik. Sikurse paralajmërimi për grevën një orëshe edhe për grevën e përgjithshme është e rëndësishme që mesazhi i paralajmërimit të jetë i qartë duke ofruar gjithashtu kontekst dhe udhëzime për publikun. (*Shih formën 15, Paralajmërimi i Këshillit Grevist për punëdhënësin për hyrje në grevë të përgjithshme*).

## **7.9 Kërkesë grupeve shoqërore për mbështetje në realizimin e kërkesave**

Gjatë kohës sa është në fuqi paralajmërimi për grevë të përgjithshme, përmes rrugëve formale Këshilli Grevist u drejtohet grupeve shoqërore për mbështetje në realizimin e kërkesave, në të cilat kërkesa ai është i qartë për objektivat dhe synimet që do t'i ndjek për arritjen e qëllimeve. (*Shih formën 16, Kërkesë grupeve shoqërore për mbështetje në realizimin e kërkesave*).

Në formën që gjendet në këtë doracak, vendosni lëndën: “Kërkesë për mbështetje në realizimin e kërkesave tona”, shprehni konsideratat për grupin shoqëror dhe kërkoni mbështetje në realizimin e kërkesave tuaja duke përkrahur shkurtimisht çështjen dhe arsyet pse do të hyni në grevë. Më tutje, jepni informacione rreth kontekstit ose sfondit për organizatën tuaj, çështjen në fjalë dhe kërkesat specifike që i keni parashtruar.

E rëndësishme për grupin që do t'i kërkoni mbështetje është specifikimi i llojit të mbështetjes, a do të jetë mbështetje financiare, mediale apo edhe pjesëmarrje vullnetare.

## **7.10 Kërkesë për takim me Avokatin e Popullit**

Sipas Kushtetutës dhe ligjit, Avokati i Popullit luan një rol vendimtar në jetën publike duke shërbyer si një avokat i pavarur dhe i paanshëm për drejtësinë, transparencën dhe llogaridhënien në qeverisje. Me faktin që këtë rol e ruan në bazë të paanshmërisë, ai ka rëndësi të veçantë në adresimin e kërkesave të sindikatave. Mbi këtë bazë, Këshilli Grevist duhet ta shfrytëzojë të drejtën që t'i drejtohet këtij institucioni për takim e që të përfshihet në adresimin e kërkesave të tyre.

Në shkresën që e përdorë KG, duhet të jetë i qartë dhe i respektueshëm ndaj Institucionit të Avokatit të Popullit. Në shkresën për takim, jepni informacion rreth kontekstit ose sfondit rreth çështjes ose shqetësimit që dëshironi të diskutoni me Ombudsmanin si dhe specifikoni kërkesat. (*Shih formën 17, Kërkesë për takim me IAP*).

## 7.11 Kërkesë për takim me Komisionin Parlamentar FunkSIONAL

Në shoqëritë demokratike parlamentare, komisionet parlamentare luajnë një rol jetik në jetën publike. Sipas Kushtetutës dhe Rregullores së Kuvendit të Kosovës, ato ofrojnë mbikëqyrje, shqyrtim dhe ekspertizë në aspekte të ndryshme të qeverisjes. Ato mbajnë përgjegjësin secilin dikaster qeveritar për veprimet e tyre duke kryer hetime, hetime dhe dëgjime publike për çështjet me interes jetik.

Duke qenë se komisionet shërbejnë si mekanizëm për mbikëqyrjen legislative, llogaridhënien dhe angazhimin publik, KG duhet të shfrytëzojë këtë mundësi që t'i drejtohet me kërkesë për shqyrtimin e çështjes së tyre. Si raste ilustrative, Sindikata e Arsimit i drejtohet Komisionit Parlamentar për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, Sindikata e Minatorëve i drejtohet Komisionit për Ekonomi etj. (*Shih formën 18, Kërkesë për takim me KPF*).

## 7.12 Vendimi për caktimin e ndërmjetësuesit

Ndryshimet ligjore që janë bërë nga Kuvendi në vitin 2012 në Ligjin për Greva kanë specifikuar procedurën e pajtimit duke përdorur procedurën e ndërmjetësimit e cila mund të jetë një instrument i vlefshëm për arritjen e marrëveshjeve dhe parandalimin e grevës.

Këto ndryshime ligjore [2], e obligojnë KG që ai të përdorë të gjitha mjetet për zgjidhjen e kërkesave ndaj punëdhënësit. Në këtë drejtim, ai është i obliguar të caktojë ndërmjetësues të licencuar nga regjistri i ndërmjetësve të Republikës së Kosovës. Një vendim të tillë duhet ta marrë Këshilli Grevist. (*Shih formën 19, Vendim për caktimin e ndërmjetësuesit*).

Në rast të marrëveshjes, ajo ka fuqi ligjore pasi që të nënshkruhet ndërmjet palëve dhe ndërmjetësit. Shpenzimet për angazhimin e ndërmjetësit të licencuar në zgjidhjen e kontestit në mes punëdhënësit dhe KG i bartin të dy palët, duke pasur parasysh tarifatat e caktuara për ndërmjetës.

Rëndësia e një marrëveshje të ndërmjetësuar zyrtarizohet me një kontratë ose marrëveshje ligjërish të detyrueshme.

---

[2] Neni 4, par. 3 dhe Neni 5, Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Greva, 2012, Gazeta Zyrtare e Kosovës (I qasshëm nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2701>). (Qasur për herë të fundit me 8 shkurt 2024).

## 7.13 Njoftimi i ndërmjetësuesit për rezultatin e dialogut me punëdhënësin

Në rastet kur ndërmjetësuesi nuk arrin rezultat pozitiv për arritjen e një marrëveshje, ai e njofton KG për rezultatin negativ të kërkesave të tij ndaj punëdhënësit të punëtorëve. Njoftimi i tij duhet të përmbajë informacione të qarta dhe të përmbledhura mbi procedurën e ndjekur dhe për shkresat dhe kërkesat drejtuar institucionit të caktuar. (*Shih formën 20, Njoftimi i ndërmjetësuesit për rezultatin e dialogut*). Në këtë rast, shpenzimet për ndërmjetësuesin nuk do t'i bartë askush ngase sipas Ligjit për Ndërmjetësim, ndërmjetësuesit i duhet paguar tarifa vetëm kur ai arrin pajtim ndërmjet palëve me marrëveshje të nënshkruar dhe zyrtarizuar.

## 7.14 Vendimi për hyrje në grevë të përgjithshme

Pas shterimit të të gjitha mjeteve për të arritur deri te një marrëveshje, KG bën përgatitjet e duhura procedurale dhe teknike për të hyrë në grevë të përgjithshme. Në përgjithësi, vendimi për të hyrë në grevë të përgjithshme është një vendim mjaft serioz dhe me pasoja që duhet pasur kujdes të madh. Por, pas shterimit të mjeteve të përmendura në këtë doracak, duke qenë se kërkesat e arsyeshme nuk janë realizuar KG e ka të detyrueshme që të hyjë në grevë. (*Shih formën 21, Vendimi për hyrje në grevë të përgjithshme*).

Sipas Ligjit për Greva, grevën mund ta organizojnë organizatat sindikale apo më shumë se 1/3 gjysma e të punësuarve<sup>[3]</sup> të një organizate të caktuar punuese, ku nuk ka organizim sindikal.

Në secilën fazë të grevës, KG është përgjegjës dhe udhëheq me grevën dhe i përfaqëson interesat e grevistëve. Ai dhe të punësuarit që marrin pjesë në grevë kanë për detyrë të organizojnë dhe të udhëheqin grevën në mënyrë që të mos rrezikohet siguria, shëndeti i njerëzve, pasuria, dhe të vazhdojnë punën pas përfundimit të grevës.

KG, ka për detyrë që në secilën ditë të grevës të mbaj regjistër të punëtorëve në grevën e përgjithshme. (*Shih Formën 22, Regjistri i pjesëmarrësve së punëtorëve në grevën e përgjithshme*).

---

[3] Neni 3, Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Greva, 2012, Gazeta Zyrtare e Kosovës (I qasshëm nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2701>). (Qasur për herë të fundit me 8 shkurt 2024).

Në raste të caktuara, në situata të ndjeshme KG i secilës sindikatë, mund t'i drejtohet anëtarësisë për t'u deklaruar në lidhje me vazhdimin e grevës apo ndërprerjes së saj duke prezantuar rezultatet e arritura nga Këshilli Grevist.

Vendimin e marrë për grevë të përgjithshme, KG, e dërgon për njoftim në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve (ish-Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale). KG, është i detyruar që edhe njoftimin për mbarimin e grevës ta dorëzojë tek i njëjti institucion brenda afatit prej dy (2) ditësh, nga data e ndërprerjes së grevës.[4]

### **7.15 Njoftimi publik për hyrje në grevë të përgjithshme**

KG, pasi që është marrë vendimi për të hyrë në grevë të përgjithshme njofton opinionin publik dhe institucionet përkatëse se punëtorët e sektorit të caktuar kanë hyrë në grevë të përgjithshme, se ata do të bashkëpunojnë me organin punëdhënës për të siguruar minimumin e procesit të punës dhe të prodhimit kur ajo punë e tillë është e domosdoshme për jetën dhe sigurinë e qytetarëve ose është kusht i pazëvendësueshëm i jetës dhe punës së qytetarëve. (*Shih formën 23, Njoftimi i publikut për hyrje në grevë të përgjithshme*).

### **7.16 Caktimi i ekipeve kujdestare dhe shëndetësore**

Pas vendimit dhe njoftimit të opinionit publik, Këshilli Grevist, është përgjegjës për të gjitha çështjet teknike dhe logjistike. Në këtë drejtim, ata janë përgjegjës edhe për caktimin e ekipeve kujdestare dhe shëndetësore në mënyrë që punëtorët që hynë në grevë të përgjithshme të kanë adresën e duhur në raste të përkeqësimit të shëndetit të tyre. Këto ekipe duhet të kenë parasysh gjithnjë për numrin e punëtorëve që kanë probleme të caktuara të qëndrimit të tyre në vendet e punës ku mund të ju përkeqësohet jeta e tyre. (*Shih formën 24, Caktimi i ekipeve kujdestare dhe shëndetësore*).

---

[4] Neni 3, Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Greva, 2012, Gazeta Zyrtare e Kosovës (I qasshëm nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2701>). (Qasur për herë të fundit me 8 shkurt 2024).



## 8. Veprimet pas hyrjes në grevë në nivel vendi

### 8.1 Kërkesë grupeve parlamentare për seancë të jashtëzakonshme në Kuvendin e Kosovës

Gjatë zhvillimit të grevës, përveç komunikimit me mediet dhe palët e tjera të interesuara, e rëndësishme është edhe komunikimi me përfaqësuesit e zgjedhur të qytetarëve, në këtë rast grupet parlamentare dhe deputetët veç e veç për t'i diskutuar dhe adresuar kërkesat e grevistëve.

KG, duhet që përmes kërkesës formale por edhe përmes takimeve t'i drejtohet përfaqësuesve të zgjedhur të qytetarëve që të thërrasin seancë të jashtëzakonshme ose kërkesë për thirrje në interpelancë për ministrin e caktuar ose për seancë dëgjimore dhe mbikëqyrëse ndaj ndonjë autoriteti të caktuar që zgjidhet nga Kuvendi i Kosovës. (*Shih formën 25, Kërkesë për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme nga Kuvendi i Kosovës*).

### 8.2 Komunikimi i përditshëm me punëtorët

Këshilli Grevist, përveç detyrave të tjera ka përgjegjësi dhe obligim që të mbajë komunikim të rregullt me punëtorët sepse është thelbësore për t'i mbajtur ata të informuar, të motivuar dhe të unifikuar në veprimet e përbashkëta.

#### Si mund të mbahet një komunikim i përditshëm?

Takime të mëngjesit, duke shpërndarë informacione të shkurtra dhe udhëzime për ditën e radhës. Ky veprim mund të bëhet me e-mail ose me takime fizike, por edhe përmes platformave siç është Viber dhe Whats app.

Çështje të tjera që mund të mbahen në informata punëtorët janë çështjet që lidhen me informacionet logjistike siç është ushqimi, pijet dhe medikamente për shëndetin e tyre. Po ashtu rol të rëndësishëm luajnë udhëzimet në lidhje me sigurinë të cilat punëtorët duhet t'i kenë në vëmendje t'u siguruar mirëqenia e tyre gjatë grevës.

---

[4] Neni 3, Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Grevën, 2012, Gazeta Zyrtare e Kosovës (I qasshëm nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2701>). (Qasur për herë të fundit me 8 shkurt 2024).

E rëndësishme gjatë zhvillimit të grevës është që KG t'i inkurajojë dhe motivojë punëtorët me fjalime të mira për t'ua ngritur moralin duke njohur sakrificat dhe kontributin e punëtorëve të kohëve të kaluara të cilët me kontributin e tyre kanë avancuar në qëllimet e grevës.

KG, duhet të theksoj rëndësinë e unitetit dhe solidaritetit midis punëtorëve, sindikatave dhe aleatëve në mbajtjen e intensitetit të grevës dhe arritjen e objektivave të saj. KG, duhet të theksojë forcën dhe fuqinë kolektive të punëtorëve kur ata qëndrojnë së bashku në solidaritet.

### **8.3 Konferencë për medie-njoftimi për rezultatin e kërkesave**

Siç dihet, qëllimi kryesor i një sindikate kur hyn në grevë ajo medoemos do ta realizojë grevën dhe do t'i mbërrijë objektivat e saj. Prandaj, kjo pjesë do t'i kushtohet vetëm një marrëveshje pozitive ndërmjet punëdhënësit dhe KG-së.

Nëse palët arrijnë marrëveshje, ata duhet që përmes një konference të përbashkët të tregojnë për arritjen e marrëveshjes dhe për çka janë dakorduar. Në këtë konferencë, ata solemnisht nënshkruajnë marrëveshjen e arritur.

---

[4] Neni 3, Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Grevën, 2012, Gazeta Zyrtare e Kosovës (I qasshëm nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2701>). (Qasur për herë të fundit me 8 shkurt 2024).

# SHTOJCAT



Instituti i Kosovës për Drejtësi  
Kosovo Law Institute  
Kosovski Institut Pravde

# Forma 1, Kërkesë për takim me punëdhënësin

## LISTA E FORMAVE (DIALOGU SOCIAL)

(Logo e Sindikatës)

Nga: \_\_\_\_\_ (Emri i Sindikatës)

Për: \_\_\_\_\_ (Emri i Punëdhënësit)

Lënda: \_\_\_\_\_ (Kërkesë për takim)

Data: \_\_\_\_\_ (Data e dërgimit të kërkesës)

I/nderuari/a, z./znj. \_\_\_\_\_ (Emri i Punëdhënësit)

Shpresoj që kjo shkresë t'ju gjejë mirë.

Ju shkruaj në emër të Sindikatës së \_\_\_\_\_ (emri i sindikatës), për të kërkuar një takim në emër të gjithë punëtorëve të sektorit të \_\_\_\_\_ (shkruaj sektorin, p.sh arsim, shëndetësi, minatorë). Qëllimi i kësaj kërkesë është të diskutohet për \_\_\_\_\_ (përshkruani shkurtimisht qëllimin e takimit, si p.sh. negocimin e kushteve më të mira të punës, adresimin e ankesave, propozimin e ndryshimeve në marrëveshjen kolektive, etj.).

Si Sindikatë, besojmë që duke u takuar mund t'i adresojmë këto çështje. Konsiderojmë se vetëm duke punuar bashkë drejt zgjidhjeve në mënyrë të përbashkët mund të sjell dobi punëtorët dhe ansjelltas. Si përfaqësues i punëtorëve, ne besojmë se dialogu social dhe bashkëpunimi i hapur janë masa për të adresuar shqetësimet që kanë lindur.

Kryesia e Sindikatës, ka identifikuar disa fusha kryesore të diskutimit, duke përfshirë (listoni tema specifike ose çështje që do të trajtohen gjatë takimit). Qëllimi ynë është të përfshihemi në dialog konstruktiv dhe të hulumtojmë mundësi për përmirësime të kushteve të punës e që përputhen me interesat e punëtorëve dhe të institucionit.

Ne jemi në dijeni për kohën tuaj të vlefshme, por ju lutem të keni në konsideratë që ta përshtatni orarin tuaj për një takim me ne. Ju lutem, të na tregoni kohën tuaj dhe ne do të bëjmë çmos për të gjetur orar dhe vend në funksion të qëllimit tonë.

Faleminderit paraprakisht që do të merrni parasysh kërkesën tonë, kërkesë për të cilën presim me padurim mundësinë për t'u takuar dhe për të diskutuar më tej çështjet e theksuara më lartë.

Nëse keni ndonjë pyetje ose keni nevojë për informacion shtesë, ju lutemi mos hezitoni të na kontaktoni në \_\_\_\_\_ (Informacioni juaj i Kontaktit).

Sinqerisht,

\_\_\_\_\_ (Emri juaj, Emri i Sindikatës)

\_\_\_\_\_ (Pozicioni ose titulli juaj)

\_\_\_\_\_ (Nënshkrimi dhe Vula)

## Forma 2, Paralajmërimi i Sindikatës për punëdhënësin për protestë paqësore LISTA E FORMAVE (TUBIMET PUBLIKE)

(Logo e Sindikatës)

Nga: \_\_\_\_\_ (Emri i Sindikatës)

Për: \_\_\_\_\_ (Emri i Punëdhënësit)

Lënda: \_\_\_\_\_ (Kërkesë)

Data: \_\_\_\_\_ (Data e dërgimit të kërkesës)

I/nderuari/a, z./znj. \_\_\_\_\_ (Emri i Punëdhënësit)

Shpresoj që kjo shkresë t'ju gjejë mirë.

Ju shkruaj në emër të Sindikatës së \_\_\_\_\_ (emri i sindikatës), për t'ju informuar për qëllimin tonë për të organizuar një protestë paqësore në përgjigje të (shpjegoni shkurt arsyen e protestës, p.sh. praktikat e padrejta të punës, pagat e vogla, kushtet e pasigurta të punës, etj.).

Përmes kësaj shkrese, për shkak të dështimit për të arritur një marrëveshje për adresimin e kërkesave të Sindikatës \_\_\_\_\_, ne ju paralajmërojmë se nëse pas një afati të arsyeshëm prej shtatë (7) ditëve, nuk zgjidhen kërkesat e tona ne do të vendim për të protestuar për realizimin e atyre kërkesave. Ne besojmë se protesta paqësore është një e drejtë themelore e punëtorëve dhe një mjet i fuqishëm për t'i realizuar kërkesat tona.

Protestën do ta zhvillojmë në mënyrë të ligjshme, paqësore dhe gjithnjë duke pasur si prioritet sigurinë dhe mirëqenien e të gjitha palëve të përfshira.

Kryesia e Sindikatës, mbetet e hapur për dialog dhe negociim, përderisa duam të theksojmë rëndësinë e adresimit të çështjeve në takimin e realizuar me datë \_\_\_\_\_.

Ju lutemi, para se të marrim një vendim për protestë të komunikoni dhe të punoni më shumë me ne ë drejt një marrëveshje të përbashkët që adreson shqetësimet e ngritura.

Nëse keni ndonjë pyetje ose keni nevojë për informacion shtesë, ju lutemi mos hezitoni të na kontaktoni në \_\_\_\_\_ (Informacioni juaj i Kontaktit).

Sinqerisht,

\_\_\_\_\_ (Emri juaj, Emri i Sindikatës)

\_\_\_\_\_ (Pozicioni ose titulli juaj)

\_\_\_\_\_ (Nënshkrimi dhe Vula)

**Forma 3, Lajmërimi i Policisë së Kosovës për mbajtjen e tubimit publik**  
**LISTA E FORMAVE (TUBIMET PUBLIKE)**



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
Qeveria – Vlada – Government  
Ministria e Punëve të Brendshme  
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova  
Ministry of Internal Affairs  
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë  
Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate



Data: \_\_\_ / \_\_\_ / \_\_\_

Në mbështetje të nenit 17 paragrafi 1, 2, 3 dhe 5 të Ligjit Nr. 08/L-166 për Tubime Publike, i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, me 27 shkurt 2023.

FORMULARI PËR LAJMËRIMIN E NGJARJES PUBLIKE

Për Stacionin Policor: \_\_\_\_\_

LAJMËRIMI I NGJARJES PUBLIKE

1. Emri Mbiemri dhe të dhëna tjera të organizatorit  
\_\_\_\_\_
2. Numri personal  
\_\_\_\_\_
3. Vendlindja dhe Vendbanimi  
\_\_\_\_\_
4. Masat për mbajtjen e rendit, qetësisë dhe të sigurisë së bashku me numrin e kujdestareve  
\_\_\_\_\_
5. Kontratën me kompaninë private të sigurisë (nëse ka)  
\_\_\_\_\_
6. Natyrën e ngjarjes publike  
\_\_\_\_\_
7. Datën kohën dhe vendin e mbajtjes  
\_\_\_\_\_
8. Numrin e përafërm të pjesëmarrësve  
\_\_\_\_\_
9. Lejen për shfrytëzimin e hapësirës nga komuna përkatëse apo institucioni përgjegjës për menaxhimin e hapësirës ku do të mbahet ngjarja publike.
  - Ngjarja publike duhet të lajmërohet me se voni shtat (7) dite para mbajtjes së saj, përjashtimisht kur Ligji për Tubime Publike, parasheh ndryshe.
  - Lajmërimi për mbajtjen e ngjarjes publike bëhet përmes formularit për lajmërimin e ngjarjes publike i cili dorëzohet nga organizatori ose përfaqësuesi i tij, në formë fizike në stacionin me të afërt policor nga vendi ku do të mbahet ngjarja publike ose në formë elektronike.

